

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE KARBURANTI PËR NEVOJAT E SHRUKD” E hapur - mbi kufirin e larte monetar-mallra -marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara.**

**Loti I Benzine 10ppm UNL**

**Loti II DIESEL/GASOIL 10ppm ULSD**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**KARBURANTE 09100000-0**

**FONDI LIMIT: 50,000,000( pesedhjetë milion) lekë pa tvsh ose 530.222,69( Peseqind e tridhjetë mijë e dyqind e njetzet e dy presje gjashtedhjetë e nente) Euro**

**Loti I - 4,152,000 (Kater milion e njeqind e pesedhjetë e dy mijë) leke pa tvsh. Ose 44.029,69 (dyzet e kater mijë e njetzet e nente presje gjashtedhjetë e nente) Euro**

**Loti II - 45,848,000 (Dyzet e pese milion e teteqind e dyzet e tete mijë) leke pa tvsh Ose 486.193,00 (Katerqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e njeqind e nentedhjetë e tre)**

**Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 22.06.2026 është 94.30 euro**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8-Kriteret e Vecanta për Kualifikim është hartuar për secilin LOT si vijon:

**Shtojca 8-LOT I Blerje Benzine 10 ppm UNL.**

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë

raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

---

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të

zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik duhet të ketë te paraqes listën e karburanteve në pronësi ose me qera apo kontrata bashkëpunimi/furnizimi të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi ku minimumi duhet të ketë stacione te tregtimit me pakice te karburanteve në Qarkun Durres dhe Tirane si me poshte :

- Në bashkinë Durres, të ketë të paktën 3 (tre) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Kavajë, të ketë të paktën 2 (dy) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Rrogozhine, të ketë të paktën 1 (nje) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Kruje/Fushe-Kruje, të ketë të paktën 2 (dy) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve,;
- Në bashkinë Shijak, të ketë të paktën 1 (nje) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve,;

Si dhe në akset kryesore rrugore si me poshtë:

- Durrës - Tiranë;
- Durrës – Vorë- Kruje
- Durres – Kavaje- Rrogozhine

Te cilat duhet te deklarohen qarte ne oferte me adrese te plote

Nr	Bashkia Durres/Kavaje/Rrogozhine/Kruje/F Kruje/Shijak	Vendndodhja (adresa)	Personi Kontakti
1			
2			
3			
4			

Në zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakice si më poshtë:

- Në pronësi ose të jone të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- Kontrata noteriale qeraje ose bashkepunimi/furnizimi;

**\*Shenim 3.3:**

Të gjitha stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve detyrimisht duhen të jone të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- a) Licence leshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakice;
- b) Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- c) Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- d) Certificate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- e) Police sigurimi në një nga shoqerite e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitje me pakice, të cilat duhet të jone brenda afatit të vlefshmerise daten e hapjes së ofertave;

***Për përmbushjen e këtij kriteri OE duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e sipercituar.***

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në lidhje me pikën a) Në bazë të nenit të 77 pika 2 , të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Në lidhje me pikën b) Keto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , Neni 77, pika 1 gërma c).

Lidhur me numrin e pikave të furnizimit është marrë në konsideratë shtrirja e madhe e territorit ku ushtron aktivitetin dhe funksionet e saj SHRUKD sh.a.. Duke marrë parasysh dhe vendodhjet të cituara në pikën 2.4.1 dhe shpërndarjen e zyrave të SHRUKD sh.a në një territor të gjerë pikave të karburantit është nevojshme që OE të ketë pikat e karburantit sipas përcaktimeve të mësipërme.

**2.4.2** Flete analiza të lëshuar nga ISHTI e cila duhet të jetë lëshuar brenda 90 diteve nga data e hapjes së ofertave;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

**2.4.3** Operatori ekonomik ofruar që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, certifikatat kërkojnë të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si më poshtë:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standartet e menaxhimit mjedisor** dhe nënvep 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të leshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë 2 viteve të fundit 2025,2026.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **2.4.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhtë**

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me tollon ose karte elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targonë e mjetit në lëng me botë, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuara, sipas adresave të kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .
- Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kerkuara mesipër, do të demonstrohen nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kerkuara mesipër në mënyrë elektronike nepermjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

**Argumentimi:** Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare, **kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative**, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin **dhe besueshmërinë**, përvojën e duhur, **si dhe personelin e nevojshëm**, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet dhe të vërtetohet që operatori ekonomik gëzon dhe zotëron kapacitetin teknik, duke krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik kontraktues do të realizojë kontratën me sukses.

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

## **Shtojca 8- LOT II Blerje DIESEL/GASOIL 10ppm ULSD.**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

## 2.5 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

f) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

## **2.6 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.6.1** Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik duhet të ketë te paraqes listën e karburanteve në pronësi ose me qera apo kontrata bashkëpunimi/furnizimi të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi ku minimumi duhet të ketë stacion te tregimit me pakice te karburanteve në Qarkun Durrës dhe Tirane si me poshte :

- Në bashkinë Durrës, të ketë të paktën 3 (tre) stacione te tregimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Kavajë, të ketë të paktën 2 (dy) stacione te tregimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Rrogozhinë, të ketë të paktën 1 (nje) stacione te tregimit me pakice te karburanteve;
- Në bashkinë Krujë/Fushe-Krujë, të ketë të paktën 2 (dy) stacione te tregimit me pakice te karburanteve;,
- Në bashkinë Shijak, të ketë të paktën 1 (nje) stacione te tregimit me pakice te karburanteve;,

Si dhe në akset kryesore rrugore si me poshtë:

- Durrës - Tiranë;

- Durrës – Vorë- Kruje
- Durres – Kavaje- Rrogozhine

Te cilat duhet te deklarohen qarte ne oferte me adrese te plote

Nr	Bashkia Durres/Kavaje/Rrogozhine/Kruje/F Kruje/Shijak	Vendndodhja (adresa)	Personi Kontakti
1			
2			
3			
4			

Në zbatim te Kodit Civil operoret ekonomik te disponojne stacione te shitjes se karburanteve me pakice si me poshte:

- Ne pronësi ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- Kontrate noteriale qeraje ose bashkepunimi/furnizimi;

**\*Shenim 3.3:**

Të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve detyrimisht duhen te jene te pajisur me dokumentacion si me poshtë:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

***Për përmbushjen e ketij kriteri OE duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e sipercituar.***

***Argumentimi:*** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ne lidhje me piken a) Në bazë të nenit të 77 pika 2 , të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Në lidhje me piken b) Keto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , Neni 77, pika 1 gërma c).

Lidhur me numrin e pikave të furnizimit është marrë në konsideratë shtrirja e madhe e territorit ku ushtron aktivitetin dhe funksionet e saj SHRUKD sh.a.. Duke marrë parasysh dhe vendodhjet te cituara ne piken 2.4.1 dhe shpërndarjen e zyrave të SHRUKD sh.a në një territor të gjerë pikave të karburantit është nevojshme qe OE te kete pikat e karburantit sipas percaktimeve te mësipërme.

**2.6.2** Flete analiza të lëshuar nga ISHTI e cila duhet të jetë lëshuar brenda 90 diteve nga data e hapjes së ofertave;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

**2.6.3** Operatori ekonomik ofruer qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe jane ne perputhje me objektin e kontrates, certifikatat kerkohen te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. si me poshte:

2. ISO 9001:2015 ose ekuivalente ne fushen e menaxhimit të cilësisë

*(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezojne certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standartet e menaxhimit mjedisor** dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise përgjatë 2 viteve te fundit 2025,2026.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **2.6.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhtë**

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me tollon ose karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave te ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targon e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri ne përfundimin e plotë të kontrates.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet karteve elektronike te personalizuara, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe shërbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, si dhe shërbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .

- Disponimi/Ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), se bashku me ofrimin sherbimeve te kerkuara mesiper, do te demostrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesemarres me shembuj per zbatimin ne praktike, ne prani anetareve te KVO-se se Autoritetit kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.
- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara mesiper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

**Argumentimi:** Kriteret per kualifikim vendosen qe ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare, **kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative**, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin **dhe besueshmërinë**, përvojën e duhur, **si dhe personelin e nevojshëm**, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet dhe të vërtetohet që operatori ekonomik gëzon dhe zotëron kapacitetin teknik, duke krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik kontraktues do të realizojë kontratën me sukses.

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim:* Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhënat teknike të Gazoil D1 10ppm USLD i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (AL ST):

- **Lëndë djegëse për automjete – Karburant Diesel/Gazoil sipas AL S SH EN 590:2025**

**Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave**

**Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive**

Treguesit	Njësia matëse	Kufijte (normat)		Metoda e Testimit
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	ASTM D 613-25
Indeksi Cetanit		46,0	-	S SH EN ISO 4264:2018
Densiteti në 15 gradë celcius	Kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0	S SH EN ISO 3675:1998 S SH EN ISO 12185:2024 ASTM D 1655-17
Hidrokarbure aromatike policiklike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916:2024 ASTM E 1655-17
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846:2019
Pika e flakerimit	Gradë celcius			S SH EN ISO 2719:2025
Graviteti API	Llogaritje			ASTM D 4052-22
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	S SH EN ISO 6245:2002
Pika e bllokimit te filtrit CFPP*	°C	-	-	S SH EN 116:2025
Korrozioni ne shufer bakri (3 orë në 50 °C	Vleresim	Klasa 1		S SH EN ISO 2160:1999
Përmbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)*	% (V/V)	-	7,0	S SH EN 14078:2025
Viskoziteti në 40 °C	m2/s	2,00	4,50	S SH EN ISO 3104:2023

Permbajtja e ujit*	% (m/m)	-	0.020	S SH EN ISO 12937:2003(2000)
Lubriciteti, ne 60°C	µm	-	460	S SH EN ISO 12156-1:2018
Pika e Turbullimit	°C	-	-	S SH EN ISO 3015:2019
Mbetje Karboni (ne 10% mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0.30	S SH EN ISO 10370:2014
Distilimi				
Distilati qe vlon deri në 250 gradë celsius	% (V/V)		65	S SH EN ISO 3405:2019
Distilati qe vlon deri në 350 gradë Celsius	% (V/V)	85		
95 % (V/V)rafinimi në	Gradë celsius		360	


### Lëndë djegëse për automjete –Benzine sipas AL S SH EN 228:2025

#### Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

#### Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Treguesit	Njësia matëse	Kufijte (normat)		Metoda e Testimit
		Minimum	Maksimumi	
Numri oktanit kerkimor RON*		95.0	-	ASTM D 2699-23
Numri oktanit motorrik, MON*		85.0	-	ASTM D 2700-23
Densiteti në 15 °C	Kg/m <sup>3</sup>	720.0	775.0	S SH EN ISO 12185:2024

				S SH EN ISO 3675:1998 ASTM D 4052-22
Përmbajtje squfurit *	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846:2019
Korrozioni ne shufer bakri (3 orë në 50 °C)	Renditje	Klasa 1		S SH EN ISO 2160:1999
Graviteti API	Llogaritje			ASTM D 4052-22
Tensioni I avujve te thate ekuivalente	kPa	45.0	100.0	S SH EN 13016-1:2024
Distilimi *				S SH EN ISO 3405:2019
Distilon deri 70°C *	% (v/v)	20.0	48.0	
Distilon deri 100°C *	% (v/v)	46.0	71.0	
Distilon deri 150°C *	% (v/v)	75.0	-	
Pika finale e distilimit *	°C	-	210	
Mbetje te distilimit *	% (v/v)	-	2.0	
Permbatja e tipit te hidrokarburit *				
Olefinat *	% (v/v)	-	18.0	S SH EN 238:1996/A1:2003
Aromariket *	% (v/v)	-	35.0	S SH EN 238:1996/A1:2003
Permbatja e benzenit *	% (v/v)	-	1.0	S SH EN 238:1996/A1:2003
Permbatja e oksigjenit *	% (m/m)	-	2.7	S SH EN 238:1996/A1:2003
Permbatja e komponimeve oksigjenore *				
Metanol (alkool metilik)	% (v/v)	-	3.0	
Etanol (alkool etilik)			5.0	

<ul style="list-style-type: none"> <li>-Alkol izopropilik</li> <li>-Alkol izobutilik</li> <li>-Alkol tercbutilik</li> <li>-Etere (me 5 ose me shume atome C)</li> <li>-Komponime oksigjenore te tjera</li> </ul>			Perzierja ne vellim I kufizuar ne 2.7% (m/m) te permbajtjes maskimale te oksigjenit	ASTM D 5845-21
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	-----------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------	----------------

Argumentimi i specifikimeve teknike është kryer nga ana e specialistëve të ngritur për këtë procedurë objekt prokurimi.